



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 26. 07. 2011, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu – Kodra, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Vjosa Osmani dhe Fatmir Limaj.

Me ftesë: z. Hajredin Kuçi – Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për integritet evropian.

Pjesëmarrës të tjerë: Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Sanije Berisha, Blerim Vela – OSBE, Besnik Ramadanaj – KDI dhe Arban Abrashi, Venera Mjekiqi – Kuvendi.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i zv.Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë z. Hajredin Kuçi, lidhur me përmbushjen e sfidave të Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2011;**

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 02/L-8 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Verërat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-024 për ndihmën shtetërore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve , me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas , me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Informatë shpesh për rishqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës , me amendamentet e komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Diskutim lidhur me hartimin e Raportit të parë të progresit të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integrim Evropian për vitin 2011
9. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet në vijim.

2. Raportim i Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi.

Kryetari – falënderoj z. Kuçi për përgjigjen e ftesës dhe për aksionin e mbrëmshëm në veri të Kosovës për sundimin e ligjit dhe ligjshmërisë në tërë territorin e Kosovës, me ministrin tha se do të flasim për të arriturat e raportit të progresit që i përket kësaj ministrie. Falënderoj për dërgimin e raportit me shkrim dhe është raporti i fundit para se të dërgohet raporti i parë tremujor për progresin e arritur në bazë të planit të veprimit për integrim evropian. Sot përveç anëtarëve të komisionit kemi edhe një deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, z. Afrim Hotin.

Hajredin Kuçi – falënderoj komisionin për ftesën për të prezantuar punën e Ministrisë së Drejtësisë për sfidat që kanë dal nga raporti i progresit për sundimin e rendit dhe të ligjit. Ne do të japim të gjitha përgjigjet e parashtruara të cilat kanë dal nga raporti i progresit për vitin e kaluar por edhe nga plani i veprimit të Kuvendit për integrim evropian. Ministria ka punuar në krijimin dhe ndërtimin e legjislacionit për ta kompletuar më të gjitha ligjet e parapara në raport të progresit për vitin e kaluar në kuadër dhe kompetenca të Ministrisë së Drejtësisë, tani janë proceduar në Kuvend me përjashtim të Kodit Penal, disa prej tyre kanë kaluar leximin parë dhe të dytë, kurse disa tjera presim shumë shpejtë të miratohen. Gjatë këtij procesi kemi qenë në koordinim të plotë me dy kritere, kriteri i

parë ka të bëjë me atë që këto projektligje të jenë të harmonizuara me kriteret evropiane dhe kriteri i *dytë* të janë funksionale për vendin tonë. Ne kemi bërë amendamentimin e Kodit Penal, dhe është përgatitur draftin final ku kemi punuar me ekspert vendor dhe ndërkombëtar. Ne kemi theksuar dy çështje që kanë dal edhe në raport të progresit, e para mos përputhshmëria në mes Ligjit për fyerje dhe shpifje dhe Kodit Penal, ne këtë e kemi ndryshuar gjatë procesit të plotësimit ndryshimit të Kodit Penal të dispozitat që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes që garantohen me konventën evropiane por edhe me liritë dhe të drejtat e njeriut. Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë për të rritur obligimet ndërkufitare dhe për të luftuar krimin ndërkufitar apo tej-kufitar, ka arritur disa marrëveshje bilaterale në fillim me disa vende fqinjë e pastaj me vendet tjera, me Shqipërinë dhe Maqedoninë është bërë një marrëveshje e tillë, kurse në fazën përfundimtare është realizimi me Malin e Zi. Ndërsa në negociata për marrëveshje jemi me Kroacinë dhe Sllovenin, kurse në fazën tjetër do të kemi marrëveshje me vendet anëtare të BE-së, me shtetet të cilat në një formë apo në një tjetër janë të qarkullueshme për individ, mallrat, shërbime dhe kapitalit me Qeverinë dhe qytetarët e Kosovës.

Natyrisht që këtë Departament sipas raportit të progresit e kemi ngritur në një Departament për bashkëpunim ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë ka ndërmarr masat për zgjidhje alternative. Sa i përket noterisë ne kemi funksionalizuar shërbimin e noterisë. Po ashtu është funksionalizuar sistemi i ndërmjetësimit, përgatitur ndërmjetësimin e parë privat, ku çdo qendër do të ndërmjetësuesit e vetë, kryesisht qendrat e mëdha. Ne kemi një marrëveshje me Këshillin Prokurorial të Kosovës sa i përket disa kompetencave që ju kaluar nga Ministria e Drejtësisë. Po ashtu për të rritur efikasitetin e Shërbimit Korrektues të Kosovës kemi bartur disa kompetenca, po ashtu është bërë një memorandum me disa organizata që monitorojnë Shërbimin Korrektues të Kosovës që është edhe kërkesë e raportit të progresit. Ne bashkëpunim me partneret ndërkombëtar dhe duke shfrytëzuar grantet e Komisionit Evropian kemi filluar ndërtimin e pallatit të drejtësisë, një burgu të sigurisë së lartë, si dhe kemi filluar ndërtimin e dy qendrave të reja të paraburgimit për Prishtinë dhe Gjilan. Po ashtu ne kemi marr masa që brenda këtyre qendrave të respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Ne jemi ballafaquar me disa sfida, problematika kryesore mbetet funksionalizimi i gjykatave në veri. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial është i gatshëm që të bartë stafin e gjyqtarët në veri. Ne jemi angazhuar dhe do të angazhohemi për ngritjen e efikasitetit të administratës në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo ministri është e interesuar që prioritetet e saj ti shtyj drejtë integrimit në Bashkimin Evropian.

Blerta Deliu – Kodra – tha se gjatë takimit që keni zhvilluar me përfaqësuesit e BE-së keni kërkuar trajtim të barabartë të Kosovës në procesin e integrimit evropian, cilat kanë qenë bisedat që keni zhvilluar në Bruksel lidhur me sfidat që kanë dal nga raporti i progresit për Kosovën.

Hajredin Kuçi – me ftesë të Komisionit Evropian jemi takuar me Komisionarin për Zgjerim dhe Drejtorin për Ballkanin Perëndimor dhe me përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave të BE-së. Në përgjithësi në ato takime kemi treguar përkushtimin tonë për integritet evropian, kemi përmendur trajtimin e barabartë të Kosovës për integritet. Ne jemi të bindur se atje ka një qasje pozitive për integritet të Kosovës, por natyrisht që ka edhe pengesa politike nga pesë vendet anëtare të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Ne

mendojmë që brenda këtij viti do të kemi lëvizje pozitive, do të avancojmë Dialogun për Stabilizim dhe Asocim, si dhe hapjen e procesit të liberalizimit të vizave. Pasi që të del raporti i progresit këtë vit do të analizohet dhe aty ku ka pasur ngecje do ti marrim parasysh dhe do ti plotësojmë.

Alma Lama – theksoj se në raportin që është sjellë, aty ku ministria ka pasur punë keni sjellë raport të detajuar për veprimet që keni ndërmarr, kurse pikatë ku nuk ka suksese dhe nuk është ndërmarr asgjë keni dhënë përgjigje politike. Do të ngriti një çështje në lidhje me Gjykatat në veri si dhe në lidhje me bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së Prokurorit të Shtetit, pyetjet kanë të bëjnë në lidhje me mos funksionimin e gjykatave në veri, pse nuk është ndërmarr asgjë? Ju thatë që do të ndërmerrni masa, por pse deri tash nuk është ndërmarr asgjë? Cilat kanë qenë raportet me EULEX-in në këtë bashkëpunim? Dhe pyetja tjetër çështja që ka të bëjë me faljen e dënimit të dënuarve me dënim për krime të rënda. Dikush i ka rekomanduar Presidentit nga Ministria e Drejtësisë emrat e tyre, kurse çka keni ndërmarr ju? (siç dihet përveç asaj të lirimit me kusht). Ju keni formuar një komision për shqyrtimin e tyre, por në lidhje me këtë çështje a ka marrë masa Ministria e Drejtësisë. Pyetje tjetër ishte për noterinë provimi është shpallur në mënyrë të padrejtë, mirëpo ju keni zgjedhur 10 noter, komisioni i ka shpallur të gjithë të pavlefshëm, pra me çfarë baze janë zgjedhur? Ju thatë në bashkëpunim me donatorët, por cilat janë kriteret që janë përdorur për të nxjerr nga të gjithë pjesëmarrësit të kësaj dhjetëshe. Të sundimi i ligjit ka pasur probleme të korrupsionit sa i përket tenderit, i cili ka qenë një tender i rregullt i cili është anuluar pa të drejtë dhe pas rishqyrtimit i është dhënë të njëjtës kompani e cila ka dështuar të sjell dokumentet më rregull, si dhe çfarë po bëni për ta luftuar korrupsionin dhe praktikat korruptive në Ministrinë e Drejtësisë.

Hajredin Kuçi – tha se në gjykatat në Mitrovicë ne kemi stafin adekuat dhe janë të gatshëm për tu kthyer në veri, por nuk mund të kthehen për shkak të mungesës së sigurisë. Ne kemi takuar përfaqësuesit vendor dhe ndërkombëtar por nuk kanë garantuar siguri për këta persona që të kthehen në veri. Nëse krijohen kushtet për siguri ata menjëherë do të kthehen në veri dhe do ti kryejnë obligimet e veta.

Alma Lama – pyeti nga kush pritet të krijohen kushtet për siguri nga EULX-i, KFOR-i apo Policia e Kosovës.

Hajredin Kuçi – tha se së cili duhet ta kryej detyrën e vet, si Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i. Nuk do të kërkohet mandat shtesë për askënd, EULEX-i dhe KFOR-i duhet ti kryejnë detyrat e tyre. Ndërsa puna organizative dhe funksionale është kompetencë e Këshillit Prokurorial. Por Qeveria e Kosovës është e gatshme ti kryej obligimet e saj. Janë marr masa të duhura, një memorandum për bartjen e kompetencave të plota të Këshillit Prokurorial, të gjitha financat, stafin administrativ, si dhe janë krijuar kushte adekuate për Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor nga barakat ku kanë funksionuar tani në ndërtesën e OSBE-së. Ashtu sikurse është premtuar nga Komisioni Evropian brenda dy viteve do të rregullohet me kushte të mira pallati i drejtësisë në Kosovë. Veprimet në raport me Prokurorinë gjithashtu bëhen duke respektuar ligjin dhe pavarësinë e plotë institucionale. Sa i përket çështjes së faljes dihet që kjo është kompetencë e Presidentit, një vërejtje është dhënë në kohën kur unë nuk kam qenë

ministër, po ashtu Presidenti formon një komision i cili zgjedh vet kënd dëshiron prej ekspertëve përfaqësues të ndryshëm dhe në atë komision rasisht ka mundur të jetë dikush nga Ministria e Drejtësisë, por jo në emër të Ministrisë. Ne nga data 21 shkurt që kemi marr mandatin e ministrit japim përgjegjësinë, por para kësaj date të gjitha çështjet kontestuese janë për Prokurorinë. Sa i përket lirimit me kusht ju e dini që ka pasur zhurmë në këtë, ne kemi ftuar pesë gjyqtarë të EULEX-it dhe kemi ftuar mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar që janë prezent në Kosovë dhe kanë marrë atë vendim për ne çdo vendim i panelit për librim me kusht publikohet nga data kur ne jemi bërë ministër. Ne si ministri jemi të obliguar të veprojmë sa herë shkelet ligji dhe ligjshmëria. Sa i përket noterisë ka qenë një keqkuptim, para se të vij unë si ministër, në nëntor të vitit të kaluar është mbajtur provimi i noterisë. Komisioni ka pasur një shkarje në mes të atij vendor dhe ndërkombëtar, të cilët nuk i kanë sjell raportet me shkrim në Ministrinë e Drejtësisë, por kanë fol në media. Në ditën që jemi takuar me komisionin kemi kërkuar të sjellin raport me shkrim i cili mund të jetë pozitivë ose negativë. Ne kemi ftuar përfaqësuesin Zviceran në përbërje të dy ekspertëve, kemi ftuar kryetarin e noterisë ndërkombëtare i cili ka ardhur personalisht vet dhe kanë rishikuar testet dhe pastaj kanë ardhur në këtë përfundim dhe i kanë miratuar. Ne sa herë që ekspertet vendor dhe ndërkombëtar kur miratojnë dhe do të dhanë mendimin e tyre, ne këtë do ta nënshkruajmë, por nëse ndodh e kundërta ne nuk do ta nënshkruajmë dhe nuk do ta japim pëlqimin tonë. Komisioni vendor dhe ndërkombëtar e kanë nënshkruar dhe është dërguar një letër nga kryetari i unionit të noterisë ndërkombëtare për përmbajtjen e provimit të noterisë dhe vlerësimeve të tyre ne ju besojmë. Çështja që ka të bëjë me prokurimin dhe ofertat korruptive; *e para* ne ju kemi dërguar një letër z. Blerim Shala, z. Isa Mustafa, z. Albin Kurti, përfaqësuesve të OJQ-ve, si Qohu, Fol, etj., që të dërgojnë vëzhguesit e tyre në procedurat e tenderimit, *e dyta* siç dihet që në të gjitha ndërtimet që kanë qenë në Ministrinë e Drejtësisë ne kemi hequr dorë, dhe qëllimi jonë nuk ka qenë të heqim dorë nga mbikëqyrja por mbi tenderimet. Ne kemi qenë në udhëtim zyrtarë kur kemi dëgjuar për një tender të ndodhur më herët, ne nuk duam të fajësojmë askënd por kemi dëgjuar që Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka dhënë një mendim ndryshe, KRPP-ja po ashtu ndryshe, ne i kemi ftuar këto organe dhe kemi dëgjuar qëndrimet e tyre dhe ne ju besojmë organeve kompetente. Nëse ka të drejtë apo jo që e njëjta firmë të aplikoj, ne nuk merrem me këtë sepse është organi kompetent për këto punë. Nëse ka veprime korruptive i ftojmë që të adresojnë me emra nga ministri e poshtë dhe po ashtu i ftojë të shkojnë në prokurori. Sa i përket Prokurorisë nuk kemi prek as njëherë, por nuk do të thotë që nuk do të prekën. Ne merremi me ligjin dhe nëse dikush ankohet dhe vërtetohet se është shkelur ligji ne do të veprojmë.

Alma Lama – ju keni marr vendim me anuluar një tender që ishte i rregullt në mënyrë që me krijuar mundësi firmës e cila ka konkurruar përpara që të ritenderohet. Kjo kompani ka punuar edhe më përpara në Ministrinë e Drejtësisë dhe është treguar jo e suksesshme, kurse vendimin që ju keni marr është i padrejtë.

Hajredin Kuçi – tha se mendojmë që keni informata të sakta sepse familjaret tuaj kanë qenë përgjegjës në këtë çështje, ne nuk kemi ndërhyrë në procedura por kemi ndërhyrë në ligjshmëri, KRPP-ja është organ i pavarur dhe ASHP-ja kanë pasur mendime të ndryshme, kurse Agjencia Antikorrupsion ka kërkuar të anulohet dhe sa herë që dikush thotë se është shkelur ligji ne do të veprojmë.

Alma Lama – a pranoi se ka pasur shkelje apo jo?

Hajredin Kuçi – po është e vërtetë se aty ka pasur shkelje.

Xhavit Haliti – E para ne kemi vërejtje në parregullsinë dhe mosfunksionimin e gjykatave dhe prokurorive që janë të shumta, pra janë shumë lëndë që kanë mbetur të bllokuara dhe nuk janë zgjidhur ende. E dyta gjykatat janë shumë pasive në ekzekutimin përmbarues të proceseve gjyqësore veçanërisht në dëmtimin e palëve, etj. Një çështje tjetër është zbatueshmëria e ligjit sepse ne po nxjerrim ligje të cilat për tu zbatuar duhet nxjerr akte nënligjore që është kompetencë e Qeverisë për zbatimin e tyre. Ne po ankohemi që po përkthejmë ligje, por është mirë që të përkthehen mirë këto ligje si dhe në procesin e miratimit, sepse po ndodh që prapë me ndryshua ato ligje, siç është rasti me Ligjin për prokurimin publik. Përmes këtij ligji kërkohet një mbikëqyrje ma e madhe e ministrave në çështjet e prokurimit e cila është kërkuar edhe nga ata të cilët na monitorojnë. Dhe po ashtu kemi një kërkesë nëse ekziston mundësia që Qeveria apo ministria të krijoj mundësinë për katër ose pesë studentë të shkëlqyeshëm të specializojnë për konstitucionalitet sepse ne kemi shumë nevojë për ta.

Hajredin Kuçi – ju e përmendet numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura i cili është një numër i madh i tyre, ne jemi duke i marr disa masa në këtë drejtim në kuadër të kompetencave që i kemi. Me mbështetjen e Kuvendit të Kosovës ne kemi marr buxhet shtesë për këtë vit për 130 gjyqtarë shtesë dhe nga 1 janari 2011, buxheti ekziston në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Çështja e dytë është se kemi siguruar buxhet 45 prokuror të rijnë si dhe janë rrit pagat në nivel të ministrave për gjyqtarët dhe prokurorët në nivel të Kosovës. Ne jemi të gatshëm që të paguajmë gjyqtarët dhe prokurorët për punën shtesë, kjo ka ndodhur me rastin e Malit të zi i cili sot ka rreth 12 mijë lëndë të pazgjidhura. Po ashtu çështja e përmbarimit, rreth 100 mijë lëndë të cilat janë të pa përmbaruara, çka do të thotë për qytetarët këto lëndë janë të pa përfunduara. Ne kemi menduar që të bëjmë një marrëveshje siç kanë bërë shumë shtete si Shqipëria dhe Maqedonia, që nga viti 2013 të bëhet edhe përmbarimi privat, siç kemi të bëjmë me lëndët e KEK-ut, PTK-së, etj. Sa i përket zbatimit të ligjeve ne mendojmë se ka disa faktor, një prej faktorëve është mungesa e kapaciteteve, e dyta nxjerrja e akteve nënligjore, në raste të caktuara ka nevojë për buxhet shtesë, por ka edhe në disa raste të mungesës së vullnetit për implementim. Përgjegjësia duhet të jetë e definuar dhe e plotë. Sa i përket ligjit për prokurimin publik ne do të kryejmë të gjitha obligimet tona në përmbushjen e detyrave që neve na takojnë. Ne kemi qenë të interesuar që të dërgojmë për studime jashtë vendi njerëz në shumë fusha si për integritet evropian, por me siguri që ka nevojë edhe në spektrin që u përmend. Në shkollat për përgatitjet në fushën kushtetuese, Ministria e Drejtësisë është e gatshme dhe kemi bërë marrëveshje me disa universitete që studentët praktikën ta bëjnë në Ministrinë e Drejtësisë. Shpesh herë ndodh që kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë janë të kufizuara përballë gjyqësorit dhe prokurorisë, por përgjegjësia na bje para opinionit publik, por ne mendojmë që secili duhet ti kryej detyrat e tij.

Xhavit Haliti – dihet që ka korrupsion në gjykata, në prokurori, etj., mund tu rriten rrogat sa doni por është e kotë sepse disa prej tyre madje do të punojnë edhe pa rrogë fare. Cila është përgjegjësia e atyre që nuk i kryejnë detyrat dhe obligimet që i kanë? Nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk i kryejnë obligimet dhe detyrat që i kanë. Mendojmë se nuk ka logjikë lënda të mos ketë një afat kur duhet të përfundohet, pra të ketë një afat të kufizuar qoftë përmes ligjeve të veçanta, akteve nënligjore, urdhërësive, etj., sepse nëse vazhdohet kështu do të kemi prapë vërejtje nga Komisioni Evropian.

Hajredin Kuçi – tha se nga viti 1989 deri në vitin 2002 nuk kemi pasur përvojë shumë, përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë është bërë nga i njëjti brumë, komisioni për përzgjedhje ka qenë tërësisht nga njerëz të huaj. Në kuadër të Këshillit Gjyqësor është themeluar edhe një Drejtorat për çështje të performancës. Ne mendojmë se ekzistojnë dy probleme kryesore: e para ka të bëjë me parashtrimin e lëndëve dhe e dyta të seleksionimi i lëndëve, këto janë raste kur njerëzit e shkelin ligjin dhe mund bëjnë vepra që janë të dëmshme për vendin. Pra kemi raste kur lënda nuk zgjidhet por zgjidhet lënda e vitit 2010 par lëndës së vitit 2002, kemi marr një iniciativë me Bankën Botërore për digjitalizimin e sistemit gjyqësor në Kosovë në mënyrë që të obligohen gjyqtarët ti publikojnë aktgjykimet në ueb-faqen e internetit dhe mbi bazën e së cilës qytetarët mund ti shohin. Çështja e llogaridhënies ne duhet ta rregullojmë me ligj, kurse çështja e parashtrimit të lëndëve duhet të rregullohet me ligj, si dhe çështja e normës duhet të rritet.

Blerim Shala – tha se luftimi i korrupsionit nuk është vetëm prioritet i juaji, por i gjithë politikës kosovare në përgjithësi, me gjasë që në çdo raport të progresit luftimi i korrupsionit do të jetë kërkesë e Komisionit Evropian, pra çka mund të bëhet më tepër dhe pse ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve do të vonohet për dy vjet objektivisht dhe kur do të miratohet ligji antimafi si shumë i rëndësishëm?

Hajredin Kuçi –kjo çështje është me rëndësi, vitin e kaluar është formuar një taskforcë kundër korrupsionit prej tetë prokurorëve, pesë vendor dhe tre ndërkombëtar, po ashtu ka pesë ekspert që janë nga fusha e shpëlarjes së parave dhe krimeve ekonomike. Ajo ka dhënë efektet e para ku janë mbi 100 raste të cilat janë proceduar në forma të ndryshme. Po ashtu kemi afruar paga të dyfishta si për prokurorët dhe për stafin mbështetës të tyre, po ashtu ju janë ofruar edhe siguri fizike disave prej tyre. Çështja e pavarësisë së gjyqësorit dhe prokurorisë në vendim marrje, kurse në prioritete duhet të jetë Qeveria dhe Kuvendi. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, ekziston një njësitë për mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të EULEX-it që funksionon me kodin e Policisë së Kosovës, dhe tani kemi përruruar burgun për dëshmitarët e mbrojtur pra kemi krijuar standarde të dyfishta. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve duhet të merr parasysh edhe specifikat e Kosovës, në veçanti për dëshmitë e rrejshme, si dhe ky ligj ka obligime rreth 7 milion implikime buxhetore dhe në KASH kemi paraparë masat e parapara që mund të merren, kemi bashkëpunim me disa shtete që i kemi mike e që bëhet transferimi i tyre, shembulli i Norvegjez atje për një ditë mbajtja kostoja është 200 euro, kurse në Kosovës rreth 27 euro dita. Sa i përket ligjit antimafi vitin e kaluar kemi pasur një kërkesë nga EULEX-i, ka pas dy dilema: a do të jetë pjesë e Kodit Penal apo ligj i veçantë, kemi ardhur në përfundim që të jetë ligj i veçantë. Në këtë vend edhe më herët Kodi i 1977 ka pasur dispozita për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme. Ne kemi Agjencinë për menaxhimin

e pasurisë së konfiskuar në mënyrë të paligjshme, ne duhet të bëjmë që ky ligj të jetë funksional. Ministria e Drejtësisë ka marr përsipër që deri në fund të vitit do të procedoj në Kuvend për miratim këtë projektligj. Kemi marr sugjerime që si model të mos merret ligji i Shqipërisë por ligji i Sllovenisë për arsye të respektimit të konventave ndërkombëtare.

Suzana Novoberdali – tha sa i përket çështjes së përmbarimit po ashtu u shpreh se është një numër vërtet i madh i lëndëve të pa përfunduar dhe pyeti si do të zgjidhen këto lëndë. Kurse sa i përket provimit të noterisë tha se janë intervistuar dhjetë kandidat, në provimin e dytë shpresojmë të jetë një numër më i madh, nevojat janë më shumë duke llogaritur në proporcion me numrin e banorëve. Në provimin e dytë për noteri kemi pakënaqësi të kandidatëve sepse në këtë provim janë lejuar të hyjnë vetëm kandidatët që kanë hyrë për herë të parë. Sa i përket pikës 36 të raportit tuaj ju njoftoj pasi që jemi edhe Kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur, se ne kemi vizituar burgun e Dubravës dhe kemi vërejtur se ka pakënaqësi si në përkujdesjen shëndetësore, në ushqim, etj. Menyja e ushqimit e cila na është treguar neve nuk e kanë pasur të burgosurit e këtij burgu, po ashtu dhe përkujdesja shëndetësor mungesa e barnave etj. Një pyetje që lidhet me pikën e 19 të raportit, a mundeni të na thoni kur do të rifunksionalizohen gjykatat në veri të Kosovës, si në Zubin Potok dhe Leposaviq?

Hajredin Kuçi – tha se ne kemi menduar përmes zgjedhjeve alternative të arbitrazhit dhe ndërmjetësimit do ti zgjidhim lëndët, shembull janë certifikatat, kontratat, etj., të cilat marrin kohë shumë për qytetarët dhe do të zgjidhen kështu që rreth 90% e lëndëve do të zgjidhen sepse ka më pak çështje penale edhe civile se sa çështje kontestimore. Ndërmjetësimi është një formë e mirë të cilës do ti jepet fuqia juridike gjithmonë kur palët pajtohen paraprakisht dhe për noteri është shembull i mirë që në fazën e parë do të shkojmë një noter për 20 mijë banorë, për fazën e dytë me 10 mijë banorë dhe kështu do të jetë më efikase. Kurse sa i përket objekteve ne jemi munduar ti riparojmë ato, janë bërë investime të vazhdueshme dhe mendojmë se janë krijuar kushtet minimale. Ne i kemi vizituar personalisht burgjet dhe jemi befasuar kur kemi parë 113 veta në shërbimin mjekësor. Ne do ta bëjmë një riorganizim më të mirë dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm dhe kualiteti i jetës çdo ditë e më shumë dhe do të respektohen të drejtat brenda ligjit që ju takojnë. Sa i përket rifunksionalizimit të gjykatave në veri në momentin kur do të krijohen kushtet për siguri, gjyqtarët dhe prokurorët janë të gatshëm të kthehen dhe të punojnë atje.

Albert Kinolli – tha se ka një pyetje për gjykatat në veri pa dashur me përsërit atë që u tha deri tani, sa i përket kushteve të sigurisë çka nëse ata që nuk ofrojnë siguri nuk duan apo nuk janë të gatshëm ende të ofrojnë siguri, a duhet ne ende të presim dhe si e vlerësoni jo-efikasitetin dhe neglizhencën e EULEX-it në mandatin dhe misionin që ka në veri për sundimin e ligjit.

Hajredin Kuçi – janë tri çështje që lidhen me veriun: 1. Kontrolli i pikave doganore; 2. Forcimi i zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës dhe 3. Funksionalizimi i gjykatave, këto janë çështje që kanë të bëjnë me rendin dhe ligjin dhe janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Qeveria e Kosovës i ka në plan të tria këto dhe me kohë do të merren masa

adekuate. Me KFOR-in kemi një marrëveshje dhe ne dëshirojmë që të kemi një marrëveshje edhe me EULEX-in, dihet mandati i tyre që kanë si në Prishtinë, Gjakovë por edhe në Leposaviq.

Afrim Hoti – pyeti a po përdorin gjykatat dhe prokurorit në veri të njëjtin Kod Civil dhe Kod Penal të Kosovës?

Hajredin Kuçi – u shpreh se janë tri kritere në sistemin e drejtësisë në Kosovë:

1. Sistemi duhet të jetë unik në gjithë territorin Kosovës; 2. Të respektohen hierarkia e emërimit nga Këshilli Gjyqësor; dhe 3. Ligjet të cilat janë të aplikuara në gjithë territorin e Kosovës, kjo nuk ka ndodhur në çdo rast. Një rast i tillë ka ndodhur në Gjykatën Supreme të Kosovës kur një gjyqtarë ndërkombëtar nuk ka zbatuar ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Në këtë rast e kemi ngritur në Gjykatën Kushtetuese dhe atë e kemi fituar qind për qind pastaj akt gjykimin e kemi dorëzuar në EULEX dhe të përfaqësuesit ndërkombëtar. Për ndryshe raste të tilla nga ajo ditë nuk kanë ndodhur.

Alma Lama - për këtë të fundit EULEX-i çfarë Kodi Penal dhe Kodi Civil përdorë? Në lidhje me korrupsionin që ngritën deputetët më herët është shumë problem në gjykata dhe prokurori, korrupsioni është shumë i madh janë përfshirë në të gjykatësit, prokurorët, avokatët, porota, etj. A mundeni të na thoni çfarë po bëni në lidhje me këtë çështje më konkretisht që prej kur keni ardhur ju si ministër? Një tjetër është korrupsioni nëpër burgje a ka ndryshuar gjendja atje duke pasur parasysh që më parë ka pasur celular në burgje, drogë, etj. Nëse ka raste kur gardianët ose punonjësit janë pushuar nga puna? Çështje tjetër shumë organizata të ashtuquajtura humanitare ose fetare operojnë në Kosovë dhe fusin shumë para në mënyrë të pakontrolluar, çfarë mund të bëhet për ta përfshirë edhe parandalimin e pastrimeve të parave.

Hajredin Kuçi – tha se sa i përket Kodit Penal apo ligjeve në Kosovës ato kanë qenë të aplikuara deri me 2008 ligjet para vitit 1989 të cilat nuk kanë qenë diskriminuese, rregulloret e UNMIK-ut, dhe ligjet që i ka miratuar Kuvendi i Kosovës. Kurse pas vitit 2008 Kuvendi ka nxjerr ligje të reja të cilat i kanë zëvendësuar rregulloret e UNMIK-ut dhe në disa momente ju kanë dhënë institucioneve vendore kompetenca më shumë, ka pasur raste kur gjykatat në veri nuk i kanë respektuar ato, por kanë respektuar gjendjen që ka qenë para vitit 2008. Kurse sa i përket korrupsionit në gjykata, ne i ftojmë edhe qytetarët që të jenë më bashkëpunues me organet e drejtësisë. Ne jemi ata të cilët krijojmë kushte, infrastrukturë ligjore dhe buxhet, por jo ata të cilët ndërhyjnë në punën e gjykatave. Por besojmë në profesionalizmin e tyre, nuk përjashtojmë mundësin e ndonjërit të korruptuar por duhet të bëjmë një dallim në mes perceptimit dhe fakteve. Kurse sa i përket burgjeve se menaxhuesve ju takon me marr vendime por jo ministrit, sepse dikush do të thotë që ministri bëri ndërhyrje në këto institucione. Ne më herët e cekem se ka raste kur unë personalisht kemi ngritur rastin në prokurori, situata në Ministrinë e Drejtësisë ka ndryshuar shumë prej që kemi ardhur ne. Ne kemi ligjin kundër shpëlarjes të parave, Qendrën e Inteligjencës Financiare ma herët ka qenë me EULEX tash janë vetëm vendorët.

Kryetari – tha për sqarim kemi një çështje, po thuhet që EULEX-i po ndërton burgje në Kosovë, dihet që deri vonë KFOR-i ka pasur të drejtë me i ndal dhe me vendos në paraburgim dhe kjo e drejtë është hequr nga ky mandat për shkak të mundësive dhe infrastrukturën që Kosova ka tash që ka përmbushur. Ju theksuat vet që këtë vit Kosova ka filluar ndërtimin e një burgu të sigorisë së lartë dhe krijimi e kushteve. A është e vërtetë që është duke u ndërtuar një qendër e tillë çfarë do që EULEX-i e quan, duke pasur parasysh mandatin e tyre dhe nëse po pse?

Hajredin Kuçi – e para ne nuk kemi një informacion të tillë, e dyta kompetencat për Shërbimin Korrektues të Kosovës qind për qind e ka Ministria e Drejtësisë dhe nëse ka informacione të tilla kisha dashur të informohem dhe me kohe do ta bëjë reagimin ligjor.

Kryetari - falënderoj zv. Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë për bashkëpunimin për realizimin e përbashkët të sfidat që dalin nga raporti i progresit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 02/L-8 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Verërat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari – E ftoi deputetin Sasha Milosavljeviq, referues i këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Sasha Milosavljeviq - Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 02/L-8 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Verërat, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-024 për ndihmën shtetërore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari – E ftoi deputetin Albert Kinolli, referues i këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Albert Kinolli - Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-024 për ndihmën shtetërore, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve , me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari – E ftoi deputeten Alma Lama, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Alma Lama – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari – E ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Blerta Deliu-Kodra – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Informatë shtesë për rishqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës , me amendamentet e komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari – tha se jemi në një situatë të re që ka të bëjë me interpretimin ligjor edhe nga zyra e Kryetarit të Kuvendit, e vetmja rrugë është që të miratohet me vërejtje që komisioni funksional pra me këtë vërejtje që Komisioni Kushtetues të marr parasysh ndryshimet e bëra.

Alam Lama – kjo është një lojë pingpongut në mes komisioneve, sa kemi ne dijeni Komisioni Kushtetues nuk ka mandat për të ndryshuar kushtetutën në këtë çështje dhe nëse ky projektligj kalon, Kuvendi ose deputetët duhet ta dërgojnë për interpretim në Gjykatën Kushtetuese, sepse ky projektligj përbën shkelje të Kushtetutës së Kosovës.

Suzana Novoberdali – tha se është e befasuar kur ka pa në rend të ditës këtë projektligj, komisioni e ka thënë fjalën e vetë. Njoftoj anëtarët e komisionit se pasi që është anëtare e Komisionit Kushtetues tha se ky komision nuk ka mandat për ta ndryshuar kushtetutën në këtë pjesë, por vetëm nëse kërkohet mandat shtesë.

Blerim Shala - tha se komisioni ka argumentet e njëjta për këtë projektligj dhe si të tillë prapë nuk e përkrahë, edhe në Kuvend do të ngritët kjo çështje. Për neve nuk është problem që të iniciohet ndryshimi i Kushtetutës edhe në këtë aspekt por tash po vërtetohet që nuk ka mandat Komisioni Kushtetues.

Kryetari – tha se vendimi mbetet në fuqi atëherë kur është marr kurse sa për njoftim mandati i komisionit është të merret me plotësimin e standardeve evropiane.

8. Diskutim lidhur me hartimin e Raportit të parë të progresit të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integrim Evropian për vitin 2011.

Kryetari - ne kemi kërkuar që të sjellën me shkrim vërejtjet ose rekomandimet për raportin e parë për këtë tremujor të planit të veprimit të Kuvendit për integrim evropian. Ne kemi një raport i cili është përgatitur nga ana e administratës nga njësi për mbështetje të komisionit dhe nga koordinatore të komisioneve parlamentare i cili do të dërgohet për miratim në seancën plenare.

9. Të ndryshme.

Kryetari - njoftoj komisioni për vizitën e bërë në Institucionin e Avokatit të Popullit. Raportin për këtë vizitë e ka përgatitur deputetja Alma Lama i cili do të dërgohet edhe të kryetari i Kuvendit me vërejtjet e caktuara.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri